



Në mbështetje të Nenit 21.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 mbi Aviacionin Civil, Titulli III, Pjesa 1, Kapitulli V, Neni 37, Rregullores No.1/2010 mbi kërkesat mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit, Rregullores No.7/2009 mbi kushtet dhe procedurat për përvetësimin, lëshimin, rinovimin dhe rizgjatjen e licencave dhe autorizimeve për stafin e aviacionit - pilotët e aeroplanëve, Rregulloren nr. 4/2008 mbi licencën e kontrollorit të trafikut ajror (amendamentuar me Rregulloren Nr. 13/2010) dhe Aneksin I të ICAO-s Kapitulli 6.

Drejtori i Përgjithshëm nxjerr këtë:

URDHËRESË ADMINISTRATIVE Nr. 1/2011

Mbi procedurat për emërimin e Qendrave Mjekësore të Aviacionit (AMC) dhe ekzaminues të autorizuar mjekësor (AME)

Neni 1

Fushëveprimi

- 1.1. Kjo Rregullore definon procedurat dhe kriteret kualifikuese për emërimin e Qendrave Mjekësore të Aviacionit (AMC) si qendra të emëruara ose të autorizuar nga Autoriteti për të kryer ekzaminime mjekësore për personelin e aviacionit dhe kriteret për emërimin e Ekzaminuesve të Autorizuar Mjekësor (AME) për të certifikuar rezultatin e ekzaminimit mjekësor dhe për të lëshuar certifikata mjekësore për stafin e aviacionit.
- 1.2. Për të kryer detyrat e tij/saj , personeli i aviacionit si pilotët/ kontrollorët e trafikut ajror/inxhinierët e fluturimit në Republikën e Kosovës duhet të kenë licencën dhe klasifikimin (*ang.rating*) përkatës duke përfshirë certifikatën mjekësore.
- 1.3. Anëtarët e ekuipazhit të kabinës duhet të kenë certifikatën mjekësore të Klasës 2 për të kryer detyrat e tij/saj.

Neni 2

Shkurtesat dhe definicionet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje përdoren shkurtesat si në vazhdim:

AMC – Qendrat Mjekësore të Aviacionit (*ang. Aeromedical Centres*); nënkupton një organizatë të kualifikuar që kryen ekzaminime mjekësore bazuar në kërkesat JAR-FCL 3, dhe që është e autorizuar nga Autoriteti.

AME- Ekzaminues të Autorizuar Mjekësor (*ang. Authorized Medical Examiner*); nënkupton një person të kualifikuar dhe licencuar në mjekësi, i cili është trajnuar në mjekësinë e aviacionit (i pranueshëm për Autoritetin).

Autoriteti - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AACK).

JAR FCL- nënkupton Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit – Licencimi i ekuipazhit të Fluturimit (JAR-FCL).

Neni 3 **Personeli i aviacionit i përfshirë**

Personeli i aviacionit që duhet të kenë certifikata mjekësore janë:

- a) Anëtarët e Ekuipazhit të Fluturimit
- b) Inxhinierët e Fluturimit
- c) Kontrollorët e Trafikut Ajror
- d) Anëtarët e Ekuipazhit të Kabinës

Neni 4 **Qendrat Mjekësore të Aviacionit-AMC**

4.1 AMC do të emërohen dhe autorizohen ose riautorizohen, varësisht nga vendimi i Autoritetit, për një periudhë jo më shumë se 3 vjet. Një AMC duhet të jetë:

- a) Brenda kufijve shtetëror të Republikës së Kosovës dhe i lidhur ose në bashkëpunim me një spital të emëruar ose një institut mjekësor.
- b) I kështur në mjekësinë klinike të aviacionit dhe aktivitete të ngjashme.
- c) I drejtuar nga një AME ose në raste të veçanta, i hapur për qasje të plote për AME përgjegjës për koordinimin e vlerësimit të rezultateve dhe nënshkrimin të raporteve dhe certifikatave dhe duhet të ketë të punësuar mjekë me trajnime të avancuara dhe përvojë në mjekësinë e aviacionit.
- d) Të kenë pajisje medicinale-teknike për ekzaminime të hollësishme të mjekësisë së aviacionit

4.2 Autoriteti do të përcaktojë numrin përfundimtar të AMC të nevojitura.

4.3 Forma për aplikim për emërim si AMC është bashkangjitur në Shtojcën 1.

Neni 5

Ekzaminues të Autorizuar Mjekësor-AME

5.1 Autoriteti do të emërojë dhe autorizojë, brenda kufijve shtetëror të Republikës së Kosovës, AME të kualifikuar dhe të licencuar në ushtrimin e detyrave në mjekësi, për një periudhë jo më shumë se 3 vjet.

5.2 Autoriteti do të përcaktojë numrin dhe lokacionin e ekzaminuesve të kërkuar, duke pas parasysh numrin e shpërndarjes gjeografike të personelit të aviacionit.

5.3 AME duhet të jenë të kualifikuar dhe të licencuar për ushtrimin e detyrës së mjekut, dhe duhet të jenë trajnuar në mjekësinë e aviacionit në pajtueshmëri me Rregulloren Nr.1/2010 (JAR-FCL AMC 3.090 (d) mbi Kërkesat Mjekësore për licencimin e ekuipazhit të fluturimit dhe/ose Rregulloren nr. 4/2008 mbi licencën e kontrollorit të trafikut ajror (amandamentuar me Rregulloren Nr. 13/2010). Ekzistojnë tri lloje të autorizimeve për AME në Republikën e Kosovës:

- a) AME-të e autorizuar për Certifikatat Mjekësore të Klasës 1, janë të autorizuar për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore për lëshimin, rinovimin dhe rivalidimin e certifikatave mjekësore për mbajtësit e licencave në të gjitha nivelet.
- b) AME-të e autorizuar për Certifikatat Mjekësore të Klasës 2, janë të autorizuar vetëm për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore për lëshimin, rinovimin dhe rivalidimin e certifikatave mjekësore për pilotët privat, aviatorët sportiv dhe për anëtarët e ekuipazhit të kabinës.
- c) AME-të e autorizuar për Certifikatat Mjekësore të Klasës 3, janë të autorizuar vetëm për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore për lëshimin, rinovimin dhe rivalidimin e certifikatave mjekësore për kontrollorët e trafikut ajror.

5.4. Një AME përgjegjës për koordinimin e vlerësimit të rezultateve dhe nënshkrimin e raporteve duhet t'i lejohet qasje në çdo dokumentacion aeromedicinal të mëhershëm dhe ekzaminimeve përkatëse, në posedim të Autoritetit, të cilat janë të nevojshme për AME për kryerjen e detyrave të tij.

5.5 Forma për aplikim për emërim si AME është bashkangjitur ne Shtojcën 2.

Neni 6 Certifikata mjekësore

6.1 Klasat e Certifikatave Mjekësore

Certifikatat mjekësore ndahen në tri klasë:

-Klasa 1:

Kërkesat mjekësore për pilotë të linjave ajrore dhe pilotë komercial, gjenden në Rregulloren Nr.1/2010 (Seksioni 1, Nën pjesa B).

-Klasa 2:

Kërkesat mjekësore për pilotët privat dhe për anëtarët e ekuipazhit të kabinës, gjenden në Rregulloren Nr.1/2010 (Seksioni 1, Nënpjesa C).

-Klasa 3:

Kërkesat mjekësore për kontrollorë të trafikut ajror, gjenden në Rregulloren Nr.4/2008 mbi licencën e kontrollorit të trafikut ajror (amandamentuar me Rregulloren Nr. 13/2010)

6.2 Validiteti i certifikatave mjekësore

6.2.1 Periudha e validitetit të një certifikate mjekësore kushtëzohet nga data e ekzaminimit fillestar aeromedicinal.

6.2.2 Certifikatat Mjekësore të Klasës 1, janë valide për 12 muaj deri në moshën 60 vjeçare, dhe pastaj valide për 6 muaj pas kësaj moshe. Kur skadon periudha e validitetit të një certifikate mjekësore të Klasës 1, vazhdon të jetë valide si një certifikate mjekësore e Klasës 2, me kusht që periudha e validitetit e përcaktuar për Klasën 2 të mos tejkalohet.

6.2.3 Certifikatat Mjekësore të Klasës 2, janë valide për 60 muaj deri në moshën 40 vjeçare, pastaj valide për 24 muaj deri në moshën 50 vjeçare dhe 12 muaj valide pas kësaj moshe. Certifikatat Mjekësore të Klasës 2 për anëtarët e ekuipazhit të kabinës janë valide për 24 muaj.

6.2.4 Certifikatat Mjekësore të Klasës 3, janë valide për 24 muaj deri në moshën 40 vjeçare, dhe 12 muaj valide pas kësaj moshe.

Neni 7

Rivalidimi i certifikatës mjekësore

7.1 Për rivalidim të një certifikate mjekësore aktuale , duhet të kryhet një ekzaminim aeromedicinal 45 ditë (gjashtë javë) para se certifikata të skadojë, me ç'rast periudha e validitetit të certifikatës së re do të llogaritet ende nga data e skadimit të certifikatës mjekësore të mëhershme.

7.2 Për rivalidim të një certifikate mjekësore të skaduar më shumë se 90 ditë (12 javë), kryhet një ekzaminim i rregullt mjekësor.

Neni 8

Ekzaminimet mjekësore

Ekzaminimet mjekësore mund të jenë fillestare, të rregullta, shtesë dhe të jashtëzakonshme ashtu siç janë definuar nga Rregulloret e Autoritetit dhe kryhen nga AMC dhe AME të autorizuar.

8.1 Ndryshimet në gjendjen shëndetësore

Nëse mbajtësi i certifikatës mjekësore është i vetëdijshëm se gjendja e tij/saj shëndetësore është përkeqësuar në atë masë që ai/ajo nuk do të ishte në gjendje të përmbushë kërkesat e sigurisë, privilegjet e licencës ose klasifikimeve përkatëse nuk duhet të ushtrohen dhe duhet të kërkohet ndihma e AME.

8.2 Evidenca e ekzaminimeve mjekësore

Evidenca e ekzaminimeve mjekësore mbahet nga AME dhe AMC në pajtueshmëri me Rregulloren Nr.1/2010 dhe Rregulloren Nr. 4/2008 mbi licencën e kontrollorit të trafikut ajror (amandamentuar me Rregulloren Nr. 13/2010). Autoriteti duhet të informohet dhe duhet të ketë qasje në të gjitha evidencat për ekzaminimet mjekësore.

Neni 9 Hyrja ne fuqi

Kjo urdhëresë administrative hyn në fuqi me datën 23 Shkurt 2011.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm